



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-149 për Ligjin e shërbimit Civil të Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, nenit 66.3 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 86 të Statutit të Komunës si dhe autorizimit të M.A.P-it bënë :

SHPALLJEN E REKRUTIMIT

I. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

TITULLI I VENDIT TË PUNËS: **VOZITËS-në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare**

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: (koeficienti 4)

Numri i referencës së vendit të punës: 03-101-5074/11

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Të transporton me automjet personelin apo klientet (kur kërkohet nga ai)
- Të bënë inspektim operacional të makinës si p.sh.: rrotat, dritat, frenat, derivatet, vajin si dhe inspektim të jashtëm, të bënë mirëmbajtjen dhe riparime të thjeshta rutinore, të raporton problemet , të garazhon dhe pastron makinën.
- Në makinë vozitësi duhet të ofrojë një atmosferë të këndshme dhe të shoqërueshem për pasagjerët dhe ti ndihmon ata në hyrje-dalje nga makina.
- Të mbanë radiolidhjen me qëllim të mbarëvajtjes së punës
- Të kompletton raportin mbi detyrat dhe aktivitetet ditore me informacionet siç janë: koha kur është operuar me makinë, numri i kilometrave të kaluara, numri i pasagjerëve dhe informata tjera të kërkuara nag mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar: - Shkolla e mesme
- Patentë shoferi

Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Njohuri dhe shkathtësi nga lëmi i vozitjes
- Njohuri bazike për mirëmbajtjen e automjetit

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Data e mbylljes së konkursit; 08.07.2011

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores -Zyra e pranimit, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale .

Kërkesat specifike: Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten edhe këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e patentë shoferit, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes .

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyren e personelit

Kaçanik; 23.06.2011

**Kryetari i Komunës
z. Xhabir Zharku**

